

TRASHËGIMIA SHPIRTËRORE ARTISTIKE E ÇAMËRISË

Ahmet MEHMETI

Akademia “Rrënjët Tona”

PËRMBLEDHJE

Aktualisht jemi në dhjetëvjetëshin e tretë të shekullit XXI dhe ende shqiptarët në librat e tyre mësimorë por edhe në antologjitë e shumta në poezi, prozë ose dramë nuk po shohin të flitet për letërsinë shqipe që u shkruajt në trojet etnike autoktone në Çamëri, tashmë nën kolonizimin mizor grek, më barbarin që ka parë e përjetuar njerëzimi ndonjë herë. Megjithëse Greqia është një shtet anëtar i Bashkimit Evropian, ajo vazhdon të ndalojë gjuhën shqipe në shkollë dhe në publik, në kushtet kur në Çamëri sot jeton një minoritet etnik shqiptar prej mbi 300 000 (treqind mijë) banorësh autoktonë, me shtrirje nga Follorina në Kostur, Konicë, Filat, Gumenicë, Paramëthi, Margëlliç, Pargë, Prevezë, Artë e Janinë. Megjithë ndalimin e shkollave shqipe dhe shkrimit në gjuhën amëtare shqipëtarët nën zgjedhën greke u morën edhe me letërsi artistike, shkruan poezi dhe prozë, drama etj pavarësisht dënimeve, ndjekjeve e burgimeve duke ndjekur traditën e shkrimit shqip në këto troje, sidomos atë të liturgjisë fetare që nga shekulli XVI, siç shtjellohet në vijim.

Fjalë kyçe: humanizmi evropian, letërsia shqipe në Çamëri, letërsia e Rilindjes Kombëtare, alhamiada shqipëtare, letërsi e krahasuar, përthyerje letrare, realizmi magjik, liria e shkrimit.

ABSTRACT

We are currently in the third decade of the XXI century and still Albanians in their textbooks but also in numerous anthologies in poetry, prose or drama are not seeng talk about Albanian literature that was written in the autochthonous ethnic lands in Chameria, already under Greek colonisation cruel, the most barbaric that humanity has ever seen and experienced. Although Greece is a member state of European Union, it continues to ban the Albanian language in schools and in public , in conditions when today in Chameria lives an ethnic Albanian minority of over 300 000 (three hundred thousand) indigenous inhabitants, extending from Florina to Kostur (Kosturia), Konica, Filat, Gumenica, Paramithia, Margëlliç (Margariti), Parga, Preveza, Arta and Ioannina. Despite the ban on Albanian schools and writing in their mother tongue, Cham Albanians under the Greek yoke also engaged in artistic literature, writing poetry and prose, drama, etc. Despite sentences, prosecutions and imprisonment following the tradition of writing Albanian in these lands, especially those of religious liturgy that from the sixteenth century, as elaborated below.

Key words: European humanism, Albanian literature in Chameria, Albanian alhamiada, National Renaissance literature, comparative literature, literary reflection, magical realism, freedom of writing.

HYRJE

Kemi hyrë në dhjetëvjetëshin e tretë të shekullit XXI dhe ende shqiptarët në librat e tyre mësimorë por edhe në antologjitë e shumta në poezi, prozë ose dramë nuk po shohin të flitet për letërsinë shqipe që u shkruajt në trojet etnike autoktone në Çamëri, tashmë nën kolonizimin mizor grek. Megjithëse Greqia është një shtet anëtar i Bashkimit Evropian, ajo vazhdon të ndalojë gjuhën shqipe në shkollë dhe në publik, në kushtet kur në Çamëri sot jeton një minoritet etnik shqiptar prej mbi 300 000 (treqind mijë) banorësh autoktonë, me shtrirje nga Follorina në Kostur, Konicë, Filat, Gumenicë, Paramëthi, Margëlliç, Pargë, Prevezë, Artë e Janinë. Megjithë ndalimin e shkollave shqipe dhe shkrimit në gjuhën amëtare shqipëtarët nën zgjedhën greke u morën edhe me letërsi artistike, shkruan poezi dhe prozë, drama etj pavarësisht dënimeve, ndjekjeve

e burgimeve duke ndjekur traditën e shkrimit shqip në këto troje, sidomos atë të liturgjisë fetare që nga shekulli XVI, siç shtjellohet në vijim. Pas Luftës së Dytë Botërore u rrit edhe interesimi i albanologëve të ndryshëm për studimin e trashëgimisë letrare-artistike që vinte nga Çamëria. Ndër të parët është Ettore Rossi në Itali me studimin “La fonte turca della novella poetica albanese “Erveheja” di Muhamet Çami (sec. XVIII-XIX) e il tema di “Florence de Rome” e di “Crescentia” në Oriente Moderno, Rome, 1948, f. 143-153. Studime për letërsinë shqipe të Çamërisë janë botuar në Rusi nga B. Sokollova: “Poema e Muhamet Çamit në përpunimin e Jani Vretos” në revistën shkencore “Filologjia Ballkanike” në vitin 1970 etj. Gjithashtu në Gjermani Armin Hetzer në vitin 1984 botoi në Mynih Studimin “Erveheja” von Muhamet Kyçyku (Çami) Eine Untersuchung zur albanischen Literatur in arabischer schrift und deren Bedeutung im Rahmen der Nationalbeëgung des 19. Jahrhunderts”. Në të gjitha rastet, studimet e botuara në Shqipëri, Kosovë, në Maqedoninë e Veriut e kudo në trojet shqiptare, si dhe nga autorë të huaj, kjo trashëgimi është parë e pandarë nga trangu i letërsisë kombëtare shqipëtare.

I. SHKRIMET NE ÇAMËRI NË SHEK. XVI

Maksim Artioti - përfaqësues i humanizmit European

Janë të njohura të dhënat për librat, dorëshkrimet dhe ekzistencën e një biblioteke në Artë dhe qytete të tjera të Çamërisë të përmendura nga udhëtarët e ndryshëm që kanë kaluar në këto rajone që nga shekulli XVI. Por nga rrebeshet e kohës si dyndjet dhe luftërat e herëpashërëshme, zhvendosjet e popullsi, djegiet e plaçkitjet, nga trashëgimia e asaj kohe mbeti vetëm çfar shkruan dëshmitarët kalimtarë dhe ndonjë dorëshkrim që me shumë peripeci shpëtoi dhe përfundoi në ndonjë bibliotekë të Perëndimit si ai që ruhet në Bibliotekën Laurenciane të Firences. Gjatë shekullit XVI, një nga figurat madhore që shkëlqeu me larminë dhe pasurinë e veprave, me veprimtarinë e gjithanëshme humanitare që lindi dhe u rrit në këtë hapësirë ishte Maksim Artioti (1470-1556), i njohur ndryshe dhe si Mihal Artioti e Mihal Trivoli në trojet shqipëtare. Në vende të tjera u njoh me emra të ndryshëm: Michele, Massimo d’Arta L’Aghiorita e Massimo il Greco në Itali; Maxim Le Grec në Francë; Maximus në SHBA dhe Maksim Grek në Rusi dhe Greqi. Lindi në Arte. Studioi për gjuhësi dhe letërsi klasike (greke e latine), për filozofi dhe letërsi kishëtare në Venedik, Firence e Paris etj gjatë një periudhe shtatëmbëdhjetë vjeçare. Mori kulturë të gjerë si humanist.

U kthye në Artë më 1507. Zotëronte: greqishten, latinishten, italishten e frëngjishten. Për aftësitë e tij u pranua në Manastirin e Vatopedit në Malin Athos. Në vitin 1515, me kërkesën e princit të Moskës Vasil Ivanoviç, shkoi në Rusi. U vendos fillimisht në Krime, ku studioi gjuhën ruse. Në vitin 1518 shkoi përfundimisht në Moskë. U ngarkua të përkthente trashëgiminë kulturore-letrare të Bizantit në gjuhën ruse. Këtu krahas përkthimeve themelore të kësaj trashëgimie u mor me publicistikë, si dhe me veprimtari humaniste për krijimin e shkollave të tipit perëndimor. Në Moskë doli haptas kundër korrupsionit dhe abuzimeve të nëpunësve të administratës qendrore dhe vendore, qëndrimi që shkaktuan pakënaqësinë e mitropolitit rus Danil dhe të princit, të cilët në vitin 1525 e dënuan si heretik. Në burg qëndroi deri në vitin 1551. Në veprën “Rrëfim i besimit ortodoks” hodhi poshtë akuzat e ngritura ndaj tij. Ishte ndërhyrja e carit Ivan Vasiljeviç që u lirua nga burgu dhe u prit me nderime në Moskë dhe u vendos në manastirin e Troice-Sergievit. Në vitin 1553, Maksimin e vizitoi Cari - Ivani i Tmerrshëm. Vdiq në Moskë. Trashëgimia e tij letrare numëron sëbashku me përkthimet mëse 150 tituj. Vepra e tij “Për gramatikën” paraqet të parën sprovë të gramatikës së sllavishtes së vjetër në Rusi. Një tjetër vepër e rëndësishme është edhe traktati “Për përkthimin” ndër të parët e llojit në literaturën botërore, pasi vetë autori njihet si një nga përkthyesit më të mëdhenj në këtë fushë prej specialistëve të sotëm. Vepra e tij e plotë u botua pas 300 vjetësh, më 1859-1862, në tre vëllime të mëdha nga Akademia Teologjike e Kazanit, u ribotua në fund të shekullit XIX në

sllavishten e vjetër dhe më 1910 në rusishte. Kisha ruse i dhe titullin më të lartë, duke e kanonizuar “Shenjtor” (Prepodobnij). Maksim Artioti shkroi dhe një vepër kushtuar atdheut të vet, Shqipërisë (Epirit): “Historia e Skenderbeut” (Povjest o Skanderbege), ku përshkroi heroizmin e Shqiptarëve (Epirotëve) në epokën më të lavdishme të tyre për liri. Ai u quajt me të drejtë nga studjuesit “Martir i qytetërimit” dhe “Unaza e lidhjes midis Perëndimit e Lindjes”

II. ALHAMIADA SHQIPËTARE

Alhamiada shqiptare është një epokë me rëndësi të veçantë në historinë e krijimit të artit poetik si i tillë dhe për vetë historinë e letërsisë shqiptare në tërësi. Gabimisht, ajo është quajtur në mënyrë nënvleftësuese si “Letërsi e bejtexhinjve” vetëm se u shkruajt me alfabet arab, gjë që e ul atë në nivelin e vargëzimit duke i mohuar vlerat e larta artistike si art i fjalës me të gjitha atributet si i tillë. Kjo dukuri nuk është vetëm shqiptare, në këtë rrugë ka ecur e zhvilluar letërsia e madhe spanjolle, ajo boshnjake, etj. Me përmirësimin e kushteve shoqërore, sidomos me një far zhvillimi ekonomik në këtë periudhë autorët shqiptarë si kudo në Shqipëri edhe në viset jugore si në Çamëri, duke u mbështetur në poezinë popullore filluan të shkruajnë në gjuhën amëtare me shkronja arabe. Por nga Lindja ata nuk morën vetëm heroglifet por përfituan shumë nga traditat e letërsive të mëdha arabe dhe persiane, të cilat kishin dhënë një kontribut të jashtzakonshëm në thesarin e artë të letërsisë botërore me kryevepra të autorëve si Firdusi, Saadiu, Khajami, Al Busiri, etj. Prej tyre poetët shqiptarë morën llojet e poezive, mësuat mjetet e shprehjes artistike, universalitetin dhe individualitetin e ndjeshmërisë, zgjeruan tematikën, laicizuan jetën shoqërore, pra u vërejtën qartë përthyerjet letrare në poezinë shqipe me dukuri krejt të reja dhe origjinale, që e integruan atë në rrjedhat e artit bashkëkohor, që për kohën ishte një zhvillim i jashtëzakonshëm.

1. **Muhamet Kuçuku Çami (1782/3 – 1844)** është një nga përfaqësuesit e shquar të kësaj epoke dhe një nga hallkat e zinxhirit midis letërsisë së vjetër shqipe dhe asaj të re, që me veprat e tij si: Gurbetlite, Erveheja, Jusufi dhe Zulejhaja, Nënshtrimi i Mesollonjës, Dorëzimi i Athinës, Muharebeja, Bekriu, etj, e pasuroi atë jo vetëm me figuracion dhe motive e tematikë të reja por edhe me forma madhore të një letërsie serioze me nivel të lartë artistik. Vlen të përmendet si merite e këtij autori lëvrimi i poemës narrative me subjekt laik që i hapën rrugën letërsisë së Rilindjes Kombëtare, veçanërisht Naim Frashërit, etj., për poemat epike. Muhamet Kuçuku Çami theu tabutë duke mposhtur moralin e asaj kohe që vazhdojnë edhe sot në poezi, duke i bërë jehonë dashurisë erotike në kuptimin dhe ndjeshmërinë më humane.

2. **Muhamet Margëllëçi** me poezitë si: “Rënkimi i Muços” dhe “Mëndja dhe Terxhubaja” të le jo pak mbresa me artin e tij poetik, ku spikat një dendësi figurash poetike si metafora, krahasimi, hiperbola që i japin poezisë së tij një nerv dhe ndjeshmëri të hollë. Kjo pasuri figurative si dhe mjeshtëria e kompozimit të vargut të bën të mendosh se autori ka pasur përvojë në artin poetik por fatkeqësisht shumë nga krijimet e tij kanë humbur. Për këtë dëshmon edhe shpërngulja e tij nga trojet e të parëve, si pasojë e furtunave të kohës si luftërat dhe pasiguria e jetës, ku mes te tjerave humbën ato që shkroi poeti lirik dhe filozof.

3. **Abdullah Alihoxha (1795/6 – 1865/6)** me përkthimin e Kaside-i Burde (Ode e Mantelit) të Al Busirit si dhe poezitë origjinale tregoi qartë se poetët shqiptarë në atë periudhë kishin arritur një shkallë zhvillimi në mjeshtërinë artistike sa mund të krahasoheshin me poetë të niveleve botërore si ishte ky i fundit në letërsinë e madhe arabe. Kjo është edhe një dëshmi se poezia në Çamëri krahasohej me atë më të mirën në vende të huaja me tradita shekullore.

4. **Marko Boçari (1790-1823)** krahas heroizmit të tij të pashoq në luftën për liri kundër otomanizmit njihet edhe për Fjalorin Greqisht-Shqip me 1494 fjalë të regjistruara me dorën e tij në Korfuz më 1809. Kuptohet se me të nuk e lidh shkenca, por gjuha amtare, shenja e identitetit të parë dhe të përjetshëm që është krahas të tjerave dhe gjuha e trashëgimisë shpirtërore. Ky Fjalor paraqet gjuhën e çamërishtes së Sulit dhe të Prevezës. Në botimin e Niko Stylos të kësaj vepre kemi një nismë për të kërkuar me përparësi gjurmët e shqipes së lashtë apo të pellazgjishtes në greqisht, etj., punë që të çon në kërkimin e rrënjëve të trashëgimisë sonë identitare, me rëndësi të jashtëzakonëshme aktuale kombëtare.

III. RILINDJA KOMBËTARE

Autorët e hershëm të Rilindjes Kombëtare Shqiptare pothuaj të gjitha krijimet e para petike i kanë shkruajtur në gjuhë të huaja. Kjo ka ardhur si pasojë e largimit të tyre nga Shqipëria, në kryeqytet, në Stamboll ose në qytete të tjera të Perandorisë Osmane, apo në Europë, atje ku përqëndrohen elitat. Kjo spjegohet edhe me nivelin e lartë të krijimeve të tyre letrare e poetike, që ishte larg nivelit të ulët kulturor të lexuesit analfabet ose lexuesit të munguar në gjuhën amtare. Në gjuhë të huaj shkruajtën Hasan Tahsini (turqisht), Jeronim de Rada (italisht), Pashko Vasa (italisht, frengjisht), Abedin Dino (greqisht, persisht, arabisht), Naim Frashëri (persisht, greqisht), Faik Konica (dy romanet në frëngjisht), etj.

1. Prof. **Hasan Tahsini (1811 – 1881)** me poezitë “Libri i Gjithesise”, “Shpendi i shpirtit” dhe “Zoti“ lëvroi poezinë kozmogonike dhe atë filozofike që ishin më afër me idealin e tij intelektual dhe shpirtëror. Megjithëse tematika e tyre është madhështore në konceptim, në pikëpamje të ndjeshmërisë ajo bëhet e thjeshtë dhe e perceptueshme për cilindo, falë figurave të qarta poetike si epiteti, krahasimi, metafora, etj. Ky personalitet i madh i shkencës shqiptare ka dhënë një kontribut të jashtzaklonshëm në Rilindjen Kombëtare si ideolog dhe mësues i rilindasve të kombit shqiptar dhe njëkohësisht në fusha të tilla si astronomia, meteorologjia, gjuhësia, psikologjia, etj., me vepra të botuara në gjuhët shqipe dhe turke të përkthyer dhe të botuara në tre vëllime në vitin 2013. Përveç këtyre Laurant Bica ka shkruajtur dhe botuar për jetën dhe veprën e tij një monografi në tre vëllime të mëdha.

2. **Abedin Dino (1843 – 1906)** me poezitë në shqip “Kënge për Shqipërinë e shqipëtarëve” dhe “Të nxiturit e Shqipërisë tuke përpjeturë” shkruar në kohën e Lidhjes së Prizrenit, është modeli i shkrirjes së artit të tij poetik me idealet kombëtare të kohës së vet. Në këto krijime poetike bie në sy simbolika kombëtare me figura të njohura si Skenderbeu dhe Marko Boçari. Ai del haptas kundër coptimit të trojeve shqiptare nga Fuqitë e Mëdha dhe paafesisë së Portes së Lartë. Ai hedh kushtrimin: “Bënuni një e lëftoni / Të bëni një Shqipërinë”, predikon luftën kundër dallimeve fetare dhe bën thirrje për shkrimin në gjuhën amtare, etj. Por mjeshterinë e lartë të artit të vet poetik ai e shprehu në poezitë e botuara në gazeta dhe revista të ndryshme, në greqisht, sidomos ato në vëllimet “POEZI” (Kostandinopol, 1888 dhe Rodos, 1894). Në këto krijime bie në sy mjeshteria e lëmimit të vargut, ritmika, melodika dhe rimat e zgjedhura, kujdesi për fjalën poetike, figuracioni i pasur dhe i larmishëm, ndjenja e hollë dhe tematika e shumanëshme. Me një bukuri dhe ndjeshmëri të mahnitëshme spikasin poezitë e dashurisë, të miqësisë, mallit për vendlindjen, ato për brengën e mërgimit etj. Për artin e tij poetik, ai është vlerësuar lartë nga kritika e specializuar e kohës së vet. Përveç letërsisë artistike Abedin Dino u mor edhe me përkthime artistike të kryeveprave të letërsisë botërore që vinë nga Lindja. Ai përktheu dhe komentoi veprën madhore të poetit persian Xhelaledin Rumi “Poema e Shenjtë” dhe atë të poetit arab Al Busiri “Poema e Mantelit”. Komentet dhe mendimet për këto kryevepra janë një kontribut i çmuar shqipëtar në mendimin estetik të kohës së vet. Abedini është ndër të parët në nivel botëror që u mor me letërsinë e krahasuar duke botuar veprën “Komenti i tregimeve arabe në Poemën

e Shenjtë”. Të tria këto vepra në turqisht që përbëjnë mbi njëmijë faqe, janë një pasuri e rrallë e kontributit të shqiptarëve në shkencat letrare me spektër ndërkombëtar.

3. **Faik Konica (1876 – 1942)**, autor i dy romaneve me temë shqiptare (në frëngjisht), me prozat “Doktor Gjilpëra”, etj. dhe poezitë e mirënjohura tashmë, e ngriti shqipen në nivelin më të lartë të gjuhës letrare duke hedhur themelet teorike dhe duke udhëhequr praktikisht me shembullin e vet krijues si dhe me përkthimet “Nën hijen e hurmave”, etj., e sidomos me publicistikën në revistën e famëshme “Albania”, si dhe në gazetatat që drejtoi dhe bashkëpunoi.

Autorë të tjerë nga Çamëria si **Ago Habib Ramo (1882)** me poezinë “Plevna”, etj., dhe **Saliko Dupi (1855-1916)** me poezinë “Lëkurësi” shprehen me ndjenja të larta humane dhe atdhetare për trimërinë e heroizmin e shqiptarëve në mbrojtje të trojeve të tyre etnike në kushtet e rënda të luftrave të pandërprera ku vihej në rrezik ekzistenca kombëtare.

IV. ROBËRIA GREKE

Pas aneksimit të Çamërisë nga Greqia në vitin e mbrapsht 1913 filloi një periudhë e errët për shqiptaret ku mohimi i gjithëçkaje, që nga pasuritë e patundeshme deri tek shkolla dhe gjuha amtare u vu në rend të ditës të të gjitha qeverive dhe shtetit grek. Në këto kushte edhe për krijuesit gjendja u bë e padurueshme, poezia dhe shkrimet e tjera filluan të shkruheshin në fshehtësi të plotë. Për t’i shpëtuar ndjekjes nga policia greke të gjithë krijuesit u detyruan të arratisen në Shqipëri ose në SHBA, Francë, etj.

1. **Haxhi Murat Çami (1875 – 1957)** shkroi kryesisht poezi me motiv atdhetar, fillimisht në Çamëri dhe shumicën në SHBA, i botoi në shtypin shqiptaro-amerikan, ndonjë edhe në Shqipëri. Në SHBA ai botoi një përmbledhje të poezive me bashkautor në vitet e emigrimit atje.

2. **Refo Çapari (1884 – 1944)** me poezitë dhe dramën e tij solli një frymë të re në poezinë shqiptaro-amerikane. Krijimtarinë e nisur në vendlindje e ngriti në një nivel të lartë artistik në Kontinentin e Ri. Për këtë vlej në të përmenden poezitë: “Çamëria”, “Lamtmirë Lili” dhe libërthi “Bërtima” (1920), etj. Disa nga librat e tij dorëshkrim, vëllime poetike dhe drama, fatkeqësisht humbën gjatë përndjekjeve e peripecive të pafundta që ushtronte shteti racist grek. Në krijimtarinë e Refo Çaparit vend të rëndësishëm zë poezia dramatike, e botuar në shtypin e kohës në SHBA. Deri tani na kanë mbërritur dramën “Rrënja” dhe “Retë”. Tek drama “Rrënja”, autori ngre probleme të mprehta që janë aktuale edhe sot në Çamëri si mospërdorimi lirshëm i gjuhës amtare, presioni i kishës greke, ndalimi i shkollave shqipe, mohimi i të drejtave të njeriut në një vend racist si Greqia etj. Në shtypin e kohës, këtyre veprave u bëhet një pritje entusiaste duke e vlerësuar autorin për rrugën e re që hap me këtë gjini të artit të fjalës së shkruar dhe skenike. Drama “Retë” e merr temën nga mitologjia shqipëtare. Kjo dramë e Refo Çaparit e bën atë pararendës të realizmit magjik në letërsinë/dramaturgjinë shqipëtare, pasi ka paraqitur me mjeshtëri realitetin duke e harmonizuar me mitologjinë shqipëtare në një mënyrë shumë tërheqëse për lexuesin / shikuesin. Ka vargje e skena që të japin krenari të jashtëzakonshme estetike për mjeshterinë e përdorimit të fjalës dhe subjekteve që vetëm Refo Çapari mund t’i paraqesë aq bukur. Edhe në këto drama fryma kombëtare është gjithnjë e pranishme me një origjinalitet krijues të admirueshëm, jo vetëm në mentalitet, veprime dhe koreografi por edhe në emrat e personazheve, të gjithë të pekatësisë etnike të trashëgimisë shqiptare si Vasho, Rica, Pilo, Frisa, Piro, Nasho, Fisie, Drita, Dona, Leka, Mina, Saqe Boti etj.

3. *Qamil Izet Çami (1885 – 1933)* me fabulat dhe poezitë e ndryshme na fut në kohën kur janë shkruajtur. Duke folur shpesh me gjuhën e Ezopit aludon për problematikën shoqërore të asaj periudhe.

4. *Hasan Pilavi (1889 – 1944)* me poezitë atdhetare përpiqet të agjitojë bashkëkombasit për aktualitetin dramatik të kohës së viteve të robërisë greke.

5. *Arif Dino (1892 – 1957)* me poezitë në frëngjisht solli një frymë të re në letrat shqiptare duke e ngritur poezinë në nivelin e bashkëkohësës së saj evropiane ku spikat stili ekspresiv dhe telegrafik, me një tematikë të larmishme dhe figuracion modernist, me dominim të metaforës.

6. *Hajri Mehmet Myderrizi* spikat me poezinë sociale.

V. TOTALITARIZMI KOMUNIST NË SHQIPËRI DHE AI RACISTO-FASHIST NË GREQI

Periudha e pas Luftës së Dytë Botërore si në Shqipëri dhe në Greqi u karakterizua njëloj për krijimtarinë letrare – artistike, ndalim i lirisë së shkrimit, veçanërisht për krijuesit çamë. Gjatë asaj periudhe, që në Greqi vazhdon edhe sot, vërehet ndalimi i shkrimit në gjuhën shqipe.

Megjithëse poeti *Ashim Sarkaro (1913 – 1996)* mori pjesë në luftën antifashiste krahas popullit grek, u dekorua për heroizëm në luftë, përsëri vetëm se ishte çam, jo vetëm nuk gëzoi pronat e veta në fshatin e tij të lindjes, në Margëlliç, por nuk u lejua të botojë në gjuhën shqipe as edhe një poezi të vetme, kështu që u detyrua të botojë vetëm në greqisht.

Në Shqipëri poeti e prozatori shumë i talentuar *Bilal Xhaferi (1935 – 1986)* për arsye politike u ndoq dhe u pengua me të gjitha mënyrat më poshtëruese të mos shkruante asgjë sipas dëshirës së tij përveç një poezie të vetme që i shpëtoi çensurës zyrtare, “Baladë Çame” (“Zëri i Rinisë”, 1966). Ky autor, që arriti të botojë dhe një libër me tregime dhe novela “Njerëz të rinj, tokë e lashtë” (1966) e vazhdoi krijimtarinë e vet si i arratisur në SHBA, ku edhe atje e ndoqi hija kobzezë e totalitarizmit nga agjentët e sigurimit të diktaturës komuniste. Kritika letrare me të drejtë e ka quajtur Bilal Xhaferin “Poet i etnisë”, pasi në themel të idealit të vet artistik kishte çështjen kombëtare. Ai nuk ju nënshtrua kurrë parimeve të socrealizmit në veprën e vet, ishte kundërshtar i vendosur i asaj metode në krijimtarinë letrare (jo disident, pasi nuk u pajtua kurrë ndonjë herë me të) dhe eci në rrugën e tradites kombëtare duke e çuar atë më tej me shume sukses. Edhe në Greqinë e sotme, në Çamëri, vazhdon të ndalohet gjuha shqipe dhe shkrimi i krijimtarisë letrare në këte gjuhë.

Niko Stylos (1946), poet dhe studjues nga Preveza është i detyruar që edhe poezitë t’i shkruaj greqisht. Vitet e fundit veprat studimore pellazgo-albanologjike si dhe vëllimet poetike të tij janë përkthyer dhe botuar në shqip në Tiranë e Prishtinë. Vëllimi poetik në shqip mban titullin “Duke farkëtuar thika” dhe vijon traditën e shkrimit të letërsisë me ideale të larta ku elementi social është shprehje e shumëfunktionalitetit të artit madhor, të cilin autori na e jep me një frymë satirike të spikatur. Të tre këta krijues janë secili një dukuri (fenomen) tipike dhe pasqyrojnë kushtet jashtëzakonisht të rënda e të vështira që u duhet krijuesve çamë të përballojnë për të mbijetuar me artin e tyre, për t’i shërbyer kulturës kombëtare dhe përparimit shoqëror. Veprimtaria e tyre krijuese si dhe vepra e tyre janë aktakuza më e fortë kundër sistemeve totalitare në Greqi, etj.

STUDIMET AKTUALE NË TIRANE, PRISHTINË, SHKUP

Pas Luftës së Dytë Botërore për letërsinë artistike në Çamëri dhe trashëgiminë kulturore të saj në Shqipëri u rrit interesimi nga ana e disa studjuesve të veçantë por jo nga institucionet e specializuara. U shqua për këtë Osman Myderrizi me studimet për “Ervehenë” e M.Kuçukut në buletinet e ndryshme shkencore, pasi puna e madhe e tij mbeti në dorëshkrim. Më vonë një punë shumë të frytëshme bëri Ibrahim D. Hoxha me përgatitjen për botim të veprës së Qamil Izet Çamit, poemës “Jusufi e Zulejhaja” të Muhamet Kuçukut, veprës së plotë të Refo Çaparit dhe Antologjisë “Poetë të Hershëm Çamë”. Përveç përkushtimit për hulumtimin, mbledhjen e përgatitjen për botim të veprave ai u përpoq të japë edhe mendimin e vet për vlerën dhe vendin që zene ato në trashëgimie tonë kombëtare. Një ndihmesë të çmuar në studimin dhe interpretimin akademik të kësaj trashëgimie të shquar ka sjelle këto vitet e fundit Prof.Dr. Bashkim Kuçuku me studimet për publicistikën dhe artin poetik si dhe botimin e Veprës letrare të Bilal Xhaferit si dhe studimet mjaft interesante për artin poetik të Muhamet Kuçuku Çamit dhe “Veprat letrare dhe studime për të” të këtij autori të madh të trashëgimisë sonë shpirtërore. Për njohjen sa më të plotë të krijimtarisë poetike të krijuar në Çamëri dhe që i kushtohet asaj, në të gjitha trevat etnike shqipëtare dhe në diasporë, Ahmet Mehmeti, me një punë studimore shumëvjeçare nxorri në dritë Antologjinë poetike “Nektar i shpirtit shqiptar” (Tiranë, 2007). Në këtë vepër përfshihen 136 poetë, 44 prej të cilëve nga Çamëria, që krijuan në një periudhë pesëqind vjeçare. Një pjesë e madhe e tyre sillen para lexuesit për herë të parë pas një heshtjeje absurde. Në këtë antologji, për herë të parë përfshihen krijime të zgjedhura me kriteret e rrepta shkencore të zhanrit të lirikës, epikës dhe dramatikës, pa përjashtuar humorin e satirën, etj. Kohët e fundit po vërehet një interesim i veçantë për studimet e trashëgimisë letrare-artistike, jo vetëm me artikuj, por edhe me tema shkencore, mbrojtje masteresh e disertacionesh që do t’i çojnë përpara studimet për këtë thesar të kulturës sonë kombëtare. Një ndër të parët e këtij lloji është dhe ai i Ardian Vehbiut për “Orientalizmat në poemën Erveheja” të M. K. Çamit”.

PËRFUNDIME

1. Ndërkohë në këta njëzet vitet e fundit studimet për trashëgiminë letrare-artistike shqipëtare të Çamërisë në Kosovë karakterizohen nga niveli i lartë shkencor dhe nga botimet e monografive dhe librave të ndryshëm.
2. Një kontribut të shquar ka dhënë Qazim Qazimi me monografinë për Muhamet Kuçuku Çamin.
3. Po kështu Akad. Sabri Hamiti me botimin e veprës së B. Xhaferit në 3 vëllime dhe librin “Poeti i nemun”.
4. Edhe Ali Podrimja me antologjinë poetike “Eni vjen prej Çamërie” dhe me vëllimin poetik “Te Guri i Prevezës” ka dhënë një ndihmesë të jashtëzakonshme për njohjen e Çështjes Çame dhe të trashëgimisë së saj të çmuar kombëtare.
5. Vlera të veçanta kanë edhe studimet e Prof. Dr. Agim Vinca për veprën dhe artin e Bilal Xhaferit.
6. Ndër autorët më të rinj përmendim Kujtim Shalën me librin për Bilal Xhaferin, me një interpretim dhe diskurs shumë interesant e bashkëkohor.

STUDIME MBËSHTETËSE DHE REFERENCA

Çami, Muhamet K. Erveheja, Maluka, 2003

- Çami, Muhamet K. Jusufi e Zulejhaja, Tiranë,1992
- Çami, Qamil I. Fabula dhe Vjersha, Tiranë, 1973
- Çapari, Refo Retë, “Yll’ i Mëngjesit”, Neë York, 1917
- Çapari, Refo Rrënja, “Përparimi”, Neë York, 1917
- Hamiti, Sabri Studime Letrare: Bilal Xhaferi, Prishtinë, 2003, f. 579-628.
- Hoxha, Ibrahim D. Poetë të hershëm çamë, Tirane, 2011
- Hoxha, Ibrahim D. Refo Çapari, Botimet Toena, Tiranë, 2006
- Kuçuku, Bashkim Muhamet Kuçuku-Çami, Vepra letrare, Tiranë, 2021
- Ledia & Silviu Mushat Enciklopedi Gjeografike e Europës, f. 166, DITURIA, 2002, Tiranë
- Mehmeti, Ahmet Fjalori Enciklopedik Shqipëtar, Akademia e Shkencave te Shqipërise, zërat: Maksim Artioti dhe Abedin Dino, Tiranë, 2008, f.129-130, 485-486.
- Mehmeti, Ahmet Abedin Dino, Onufri, Tiranë, 1998
- Mehmeti, Ahmet Nektar i shpirtit shqipëtar, ISÇ- Arbëria, Tiranë, 2007.
- Sokollova, B. Ballkanskaja Filologia: Poema Muhameda Çamerijskogo v pererabotke Jani Vreto, Leningradskij Universitet, 1970, f. 117-126
- Stylos Niko Fjalori i Marko Boçarit, ARBERIA, Tiranë, 2007
- Stylos, Niko Duke farkëtuar thika, Essen, 1978 – Tiranë, 2011.
- Stylos, Niko Preveziani Abedin Pasha Dino, poezitë e tij dhe Dinot e tjerë. T. 2014
- Xhaferi, Bilal Vepra në 5 Vëllime.Përgatiti Bashkim Kuçuku, Arbëria, Tiranë, 2010.